



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 145/6 Prot

Tiranë, më 10.06.2021

**V E N D I M**

Nr.70, datë 10.06.2021

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procesit të transferimit të përhershëm të nëpunësit \*\*\*\*\* , nga pozicioni “Drejtor në Drejtorinë e Punëve dhe Shërbimeve”, kategoria e pagës II-b, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile”, kategoria e pagës III- a/1, për shkak të ristrukturimit të institucionit Bashkia Vorë.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e rastit të nëpunësit \*\*\*\*\* , i cili e konsideron të paligjshëm transferimin e përhershëm të tij, për shkak të ristrukturimit të institucionit Bashkia Vorë,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 145 prot., datë 15.2.2021 dhe 145/1 prot., datë 17.2.2021, nëpunësi \*\*\*\*\* , ka parashtruar pretendimin se, transferimi i tij për shkak të ristrukturimit të institucionit, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile”, në Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi dhe Emergjencat Civile, kategoria e pagës III- a/1, është i padrejtë, për dy shkaqe të përmbledhura prej tij:

Së pari, para ristrukturimit ai ishte i emëruar në pozicionin e nivelit të mesëm drejtues “Drejtor në Drejtorinë e Punëve dhe Shërbimeve”, kategoria e pagës II-b, ndërsa pas ristrukturimit është transferuar në pozicionin e nivelit të ulët drejtues “Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile”, në Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi dhe Emergjencat

Civile, kategoria e pagës III a/1, me ulje në kategorinë e pozicionit të punës dhe ulje në nivelin e pages;

Së dyti, ai pretendon se, në strukturën e re, “*Drejtoria e Punëve dhe Shërbimeve*” është ruajtur me të njëjta funksione, vetëm ka ndryshuar emërtesën duke u bërë “*Drejtoria e Mirëmbajtjes dhe Mbikëqyrjes së Infrastrukturës*”, dhe pozicioni i drejtorit është vend i lirë.

Me pretendimet si më sipër, ai ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera në rastin e transferimit të përhershëm të tij për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Në kuadër të verifikimit të këtyre pretendimeve, u kërkua në Bashkinë Vorë, gjithë dokumentacioni që materializon veprimet administrative të kryera në këtë rast, nga shqyrtimi i të cilit rezultoi e vërtetuar sa më poshtë:

Kërkuesi \*\*\*\*\*, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, të hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, me aktin nr. 474 prot., datë 20.7.2020, të njësisë përgjegjëse të Bashkisë Vorë, është emëruar nëpunës civil në pozicionin e nivelit të mesëm drejtues “*Drejtor në Drejtorinë e Punëve dhe Shërbimeve*”, në Bashkinë Vorë, kategoria e pagës II-b.

Ndërkohë me urdhrin nr. 7 (96 prot.), datë 7.1.2021, të Kryetarit të Bashkisë Vorë, “*Për miratimin e strukturës së Bashkisë Vorë dhe njësisë administrative Prezë dhe Bërxull për vitin 2021*”, është miratuar struktura dhe organika e Bashkisë Vorë, për vitin 2021 e për implementimin e saj, me aktin nr. 10 (143 prot.), dt. 8.1.2021 të titullarit, “*Për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit në Bashkinë Vorë*”, është ngritur Komisioni i Ristrukturimit, i cili ka marrë në shqyrtim sistemimin e nëpunësve në pozicionet e reja të punës, të krijuara apo riorganizuar sipas strukturës së re, duke paraqitur para njësisë përgjegjëse propozimet përkatëse.

Ndër të tjera, rezultoi se për nëpunësin \*\*\*\*\*, është propozuar transferimi i përhershëm i tij nga pozicioni “*Drejtor në Drejtorinë e Punëve dhe Shërbimeve*”, në Bashkinë Vorë, kategoria e pagës II-b, në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile*”, në Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi dhe Emergjencat Civile, në Bashkinë Vorë, kategoria e pagës III-a/1. (*Vendim nr. 143/1 prot., datë 18.1.2021, i Komisionit të Ristrukturimit të Bashkisë Vorë; ndarja 10*).

Këtë propozim, e ka miratuar pa vërejtje edhe njësia përgjegjëse, e cila nëpërmjet aktit nr. 713 prot., datë 28.1.2021 (*ndarja 10 e tij*), ka vendosur transferimin e përhershëm të nëpunësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile*”, në Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi dhe Emergjencat Civile, në Bashkinë Vorë, kategoria e pagës III-a/1.

Kërkuesi nuk ka qenë dakord me aktin e transferimit të përhershëm e për këtë arsye me shkresën (memo) nr. 912 prot., datë 5.2.2021, i është drejtuar njësisë përgjegjëse duke parashtruar pretendimin se në strukturën e vjetër ai ishte i emëruar në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Publike”. Funkcionet e kësaj drejtorie, në strukturën e re i kryen “Drejtoria e Mirëmbajtjes dhe Mbikëqyrjes së Infrastrukturës”, e për këtë arsye sipas tij, nuk justifikohet transferimi në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile”, që është pozicion i një kategorie më të ulët se pozicioni i mëparshëm e për pasojë ka edhe pagë më të ulët.

Në përgjigje, njësia përgjegjëse me shkresën nr. 912/1 prot., datë 8.2.2021, ka sqaruar nëpunësin se, sistemimi në pozicionin që ka marrë funksionet e pozicionit të mëparshëm është i pamundur, pasi kanë ndryshuar kërkesat e posaçme për vendin e punës dhe se bazuar në të dhënat lidhur me kualifikimin arsimor dhe përvojën e tij në punë, ka qenë i pamundur emërimi në këtë pozicion si dhe transferimi në një pozicion tjetër të të njëjtës kategori.

Kërkuesi nuk ka qenë dakord me përgjigjen si më sipër, e për këtë arsye pretendimet në lidhje me transferimin e përhershëm për shkak të ristrukturimit të institucionit i ka paraqitur pranë Komisionerit nëpërmjet kërkesave të regjistruara me nr. 145 prot., datë 15.2.2021 dhe nr. 145/1 prot. datë 17.2.2021, të cilat përbëjnë objektin e këtij verifikimi.

Nga analiza e materialit të administruar rezulton që, shkak i mosmarrëveshjes administrative ndërmjet nëpunësit \*\*\*\*\* dhe institucionit Bashkia Vorë, lidhet me implementimin e urdhërit nr. 7 (96 prot.), datë 7.1.2021, të Kryetarit të Bashkisë Vorë, “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Vorë dhe njësive administrative Prezë dhe Bërxull për vitin 2021”. Sipas strukturës së mëparshme ankuesi ishte i punësuar në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Punëve dhe Shërbimeve”, në Bashkinë Vorë, kategoria e pagës II-b. Në kuadër të ristrukturimit kjo drejtori është ristrukturuar duke u emërtuar “Drejtoria e Mirëmbajtjes dhe Mbikëqyrjes së Infrastrukturës” e në të njëjtën kohë duke përshtatur dhe specifikuar, kompetencat dhe objektivat e punës, në përputhje me qëllimin për të cilin u krye ky riorganizim. Për të sqaruar se çfarë ka ndryshuar në kërkesat e veçanta të vendit të punës, të cilat kanë shtyrë Komisionin e Ristrukturimit dhe njësinë përgjegjëse që të transferojë nëpunësin në fjalë, në një pozicion të një kategorie nëpunësie dhe page më të ulët se pozicioni që ai mbante para ristrukturimit, me shkresën 145/2 prot., datë 10.3.2021, të Komisionerit, u kërkua nga institucioni përshkrimi i pozicionit të mëparshëm të punës dhe përshkrimi për pozicionin që ka marrë funksionet e tij në strukturën e re.

Në përgjigje, Bashkia Vorë me shkresën nr. 2309/2 prot., datë 7.5.2021, ka dërguar përshkrimin e punës për pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Mirëmbajtjes dhe Mbikëqyrjes së Infrastrukturës”, që është pozicioni që ka marrë përgjegjësitë dhe detyrat e drejtorisë së mëparshme dhe kopje të shpalljes së konkurrimit për pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Punëve dhe Shërbimeve”, procedurë në të cilën nëpunësi në fjalë u shpall fitues dhe vazhdoi të punonte nga data 20.7.2020, deri në momentin e ristrukturimit. (Shkresa nr. 3155/4 prot.,

datë 21.5.2020, shpallje e procedurës për lëvizje paralele, ngritje në detyrë, të hapur edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil për pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Punëve dhe Shërbimeve, në Bashkinë Vorë, kategoria e pagës II-b).

Nga krahasimi i kërkesave specifike të vendosura për pozicionin e mëparshëm me kërkesat e vendosura për pozicionin që ka mbartur funksionet e tij në strukturën e re, rezultojnë se:

Për pozicionin *“Drejtor në Drejtorinë e Punëve dhe Shërbimeve”* që është pozicioni i mëparshëm, kërkohet që *“Kandidati të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor”, apo “Master Profesional” në shkencë Juridike, Ekonomike, etj. Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 3 vite në administratën publike”*. Ndërsa, për pozicionin *“Drejtor në Drejtorinë e Mirëmbajtjes dhe Mbikëqyrjes së Infrastrukturës”*, që ka marrë kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrat e pozicionit të mëparshëm, por të përshtatura me detyrat dhe objektivat e reja të institucionit, është kërkuar që nëpunësi që do të mbajë këtë pozicion duhet që *“Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor”, në fushën Juridike ose Ekonomike dhe të ketë eksperiencë pune mbi 3 vjet në administratën publike”*.

Nga verifikimi i të dhënave të tij, të administruara në dosjen e personelit në lidhje me arsimin, rezultojnë se nëpunësi \*\*\*\*\* zotëron Diplomë *“Bachelor”*, në *“Shkencat e lëvizjes”*, Nr. 623, data e lëshimit 01.09.2016, Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes; Diplomë *“Master Profesional”*, në *“Mësuesi për Arsimin e Mesëm në lëndën Edukim Fizik”*, Nr. 450, data e lëshimit 05.06.2017, Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes.

Bazuar në të dhënat e përmendura si më sipër, rezultojnë se në kërkesat e mëparshme të vendit të punës, është përdorur shprehja *“diplomë e nivelit “Master Shkencor”, apo “Master Profesional” në shkencë Juridike, Ekonomike, etj”*, që do të thotë se fusha e studimeve universitare apo profili i arsimit të lartë që duhet të kishte kandidati apo nëpunësi që do të emërohej në këtë pozicion ishte lënë shumë i gjërë, pothuaj i papërcaktuar/e hapur për të gjitha profilet e arsimit të lartë. Ndërsa në kërkesat për pozicionin *“Drejtor në Drejtorinë e Mirëmbajtjes dhe Mbikëqyrjes së Infrastrukturës”*, që ka marrë funksionet e pozicionit të mëparshëm dhe që pretendohet prej kërkuesit, është përdorur shprehja *“diplomë e nivelit “Master Shkencor”, në fushën Juridike ose Ekonomike”*. Në këtë rast, fusha e studimeve universitare apo profili i arsimit të lartë që duhet të ketë kandidati apo nëpunësi i cili do të emërohet në këtë pozicion është i përcaktuar më saktë dhe i lidhur ngushtë me natyrën e detyrave dhe kompetencave, që i janë ngarkuar pozicionit të ri, përshtatur sipas objektivave të reja të institucionit.

Duke analizuar gjendjen e fakteve si më sipër, bazuar në pikën 1, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se, nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më ose është ristrukturuar, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të

së njëjtës kategori, gjë që do të thotë se ai mund të transferohej për këtë shkak, në një pozicion të nivelit të mesëm drejtues.

Në rastin në shqyrtim, duke qenë se nëpunësi **\*\*\*\*\***, nuk mund të emërohej në pozicionin e ristrukturuar “*Drejtor në Drejtorinë e Mirëmbajtjes dhe Mbikëqyrjes së Infrastrukturës*”, për shkak se nuk plotësonte kriterin arsimor dhe njëkohësisht ka shprehur rezerva për transferimin në një pozicion një niveli më të ulët, atëherë Komisionit të Ristrukturimit të Bashkisë Vorë, i binte për detyrë që në këtë rast të merrte pëlqimin e tij në momentin që çmoi ti ofrojë një pozicion të një kategorie më të ulët, duke i shpjeguar edhe arsyet e këtij veprimi. Në rast se ai e refuzonte përfundimisht, me shkrim, pozicionin e ofruar atëhere, bazuar në pikën 1, të nenit 66, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duhej të propozonte përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të tij, dhe përfitim sipas pikave 7 e 8, të nenit 50, të ligjit 152/2013, i ndryshuar, ku përfshihet një dëmshpërblim në përputhje me vjetërsinë e tij në shërbimin civil, sipas rasteve të parashikuara në këtë dispozitë, duke ruajtur statusin e nëpunësit civil, kategoria e mesme drejtuese në shërbimin civil, dhe konfirmimin e të drejtës që brenda një periudhe 2- vjeçare:

a) të konkurrojnë si nëpunës civil për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji;

b) të emërohet në mënyrë të përkohshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tij, në pozicione të shërbimit civil.

Nisur nga sa më sipër, arrihet në konkluzionin se, nga ana e njësisë përgjegjëse të Bashkisë Vorë, në veprimet e kryera në rastin e nëpunësit **\*\*\*\*\***, nuk janë mbajtur parasysh të gjitha kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil në kryerjen e këtij procesi, pasi si në momentin e punësimit në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Punëve dhe Shërbimeve*”, ashtu edhe në ofrimin atij për shkak ristrukturimi, të pozicionit “*Drejtor në Drejtorinë e Mirëmbajtjes dhe Mbikëqyrjes së Infrastrukturës*”, nuk është mbajtur mirë parasysh dhe nuk është saktësuar problemi nëse ai e plotësonte kriterin arsimor në gjithë elementët e tij, si për pozicionin e mëparshëm (për klasën drejtor drejtorie) ashtu dhe për pozicionin e ofruar (për klasën shef sektori).

Sipas parashikimeve të ndarjes 2/2, të lidhjes 2, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*” i ndryshuar me VKM nr. 765, dt. 26.12.2018, për klasat II/1, II/2, III/1 dhe III/2, ku përfshihen pozicionet e punës me emërtesën “*Drejtor drejtorie*” dhe “*Shef sektori*”, kërkohet “*Master shkencor apo Master profesional, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike*”. Ky është një moment që njësia përgjegjëse duhet të kishte treguar dhe duhet të tregojë në të ardhmen, kujdes maksimal në vlerësimin e kandidatave pjesëmarrëse në konkurrim për plotësimin e pozicioneve të lira (duke kërkuar prej konkurrentëve, dokumentin e institucionit arsimor, për plotësimin e kohës dhe krediteve të ciklit master profesional/shkencor). Në këtë prizëm, në rishqyrtimin e rastit në fjalë, nga

ana e Komisionit të Ristrukturimit, duhet të mbahet parasysh e të rivlerësohet nëse nëpunësi \*\*\*\*\* , e plotëson kriterin arsimor, si në drejtim të llojit të kualifikimit ashtu dhe në drejtim të nivelit të kualifikimit, për transferimin e tij, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile”, në Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi dhe Emergjencat Civile, në Bashkinë Vorë.

Nëse arrihet në përfundimin që ai e plotëson kriterin arsimor për pozicionin në fjalë, projekti i aktit për transferimin e përhershëm, duhet ti njoftohet nëpunësit, i cili duhet të shprehë me shkrim vullnetin e tij, nëse e pranon ose jo pozicionin. Nëse ai e pranon transferimin e përhershëm të tij, në pozicionin e propozuar “Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile”, në Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi dhe Emergjencat Civile, në Bashkinë Vorë, atëhere kjo duhet të shoqërohet me aktin e njësisë përgjegjëse për transferimin e përhershëm në atë pozicion.

Në eventualitetin që nëpunësi deklaron se nuk e pranon pozicionin e ofruar, atëhere komisioni i ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse duhet të zbatojnë rregullat e ristrukturimit të parashikuara në dispozitën e sipërpërmendur dhe në pikën 1, gërma a), e nenit 66, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Me këtë rast, duhet të korrigjohet edhe gabimi material që është bërë në emërtimin e aktit individual të transferimit, ku është përdorur shprehja “transferimin e përkohshëm”. (Vendim nr. 791 prot., dt. 1.2.2021, i njësisë përgjegjëse, “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”), I gjithë procesi administrativ për të cilin u fol më lart, ka të bëjë me transferimin e përhershëm të nëpunësit për shkak të ristrukturimit të institucionit, prandaj shprehja “transferimin e përkohshëm” vjen në kundërshtim me përmbajtjen e procesit administrativ të kryer. Në këto kushte, bazuar në nenin 112, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, organi publik që ka nxjerrë aktin, duhet të korrigjojë këtë pasaktësi, duke përdorur termin “transferimin e përhershëm”.

Përfundimisht, për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë, bazuar në pikën “b”, të nenit 109, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, aktet e dala në këtë proces, për rastin që i përket nëpunësit \*\*\*\*\* , të vlerësohen si akte të paligjshme dhe si të tilla, bazuar në nenin 113, të ligjit në fjalë, duhet të anulohen nga vetë organi publik, njësia përgjegjëse e Bashkisë Vorë, e cila duhet të riorganizojë përsëritjen e procesit të ristrukturimit.

Komisioni i Ristrukturimit, me përbërje të njëjtë si më parë, duhet të përsërisë procesin për rastin në fjalë dhe në këtë kuadër, të verifikojë diplomën që zotëron nëpunësi në gjithë elementët e saj, sipas kërkesës së legjisllacionit të shërbimit civil dhe në përfundim, nëse do të mbajë të njëjtin qëndrim si më parë, të njoftojë nëpunësin \*\*\*\*\* , për aktin e Komisionit të Ristrukturimit, për transferimin e përhershëm të tij në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile”, në Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi dhe Emergjencave Civile, për shkak të ristrukturimit të institucionit. Pas kësaj, të kërkohet prej

tij që brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, të shprehë mendimin e tij me shkrim, nëse e pranon apo e refuzon pozicionin e ofruar. Nëse refuzohet pozicioni i ofruar, atëhere siç u tha dhe më lart, duhet të vijojnë procedurat për zbatimin e rregullave të përcaktuara në pikën 1, germa a), e nenit 66, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 90/1, 109, germa d), neni 113 dhe nenin 114/1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në mbështetje të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga organi publik, njësia përgjegjëse e Bashkisë Vorë që, të verifikojë faktin nëse punonjësi \*\*\*\*\*, i plotëson kërkesat e posaçme në rastin e Masterit profesional (120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike) dhe nëse ai i plotëson ato të përsërisë njoftimin zyrtar, për propozimin e Komisionit të Ristrukturimit për transferimin e përhershëm të tij, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile”, në Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi dhe Emergjencat Civile, për shkak të ristrukturimit të institucionit. T’i kërkohet nëpunësit në fjalë që brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, të shprehë mendimin me shkrim, nëse ai e pranon apo e refuzon pozicionin e ofruar.
1. Nëse nëpunësi shpreh refuzimin për pozicionin e ofruar, njësia përgjegjëse të konstatojë paligjshmërinë e aktit individual të transferimit të përhershëm (vendimi nr. 791 prot., dt. 1.2.2021, i njësisë përgjegjëse, “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”) dhe nr. 31 (971 prot.) datë 9.2.2021, i Kryetarit të Bashkisë Vorë, “Deklarimin e transferimit në shërbimin civil”, të nxjerrin aktin e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil përmes lirimit për shkak të ristrukturimit të institucionit për këtë punonjës, duke i njohur, në mënyrë të shprehur në këtë akt, të drejtat si më poshtë:
  - të drejtën e një dëmshpërblimi, në përputhje me vjetërsinë e tij në shërbimin civil;
  - të drejtën që, brenda periudhës 2-vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil:
    - a) të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji;
    - b) të emërohen në mënyrë të përkohshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tij, në pozicione të shërbimit civil.

*(Të drejtat e përmendura në shkronjën a) dhe b) nëse plotëson kërkesat e arsimit për “Masterin profesional”, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike)*

2. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat **15 ditë**, nga marrja dijeni për këtë vendim.
3. Me kalimin e këtij afati, të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Të njoftohet për këtë vendim institucioni Bashkia Vorë dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**